



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/77
Datë: 04.12.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017, me Rregulloren nr. 07/2018 dhe me Rregulloren nr. 22/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Procedurën Kontestimore.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

KONCEPT DOKUMENTI PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Kapitulli I

Hartimi i Koncept Dokumentit për Procedurën Kontestimore parashikohet në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2017, në kuadër të Prioritetit Strategjik të Qeverisë Nr. 2. Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit objektivit 2.1 "Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe fuqizimi i të drejtave pronësore", "Unifikimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën e të drejtave pronësore.

Kjo çështje është e ndërlidhur me Strategjinë Kombëtare për të Drejtat Pronësore (SKDP), e miratuar në vitin 2017, e cila ka për qëllim sigurimin e të drejtave pronësore duke e forcuar kuadrin ligjor dhe duke adresuar informalitetin në sektorin e pronës së paluajtshme. SKDP parashikon zhvillimin e një procedure të veçantë për kërkesëpaditë lidhur me të drejtat pronësore; procedurat e njoftimit për ta zgjeruar shtrirjen me informim; tarifën e unifikuar gjyqësore për kërkesëpaditë lidhur me të drejtat pronësore, rishikimin dhe zbatimin e dispozitave për përdorimin e gjuhës në Ligjin për Procedurën Kontestimore.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 parasheh masa konkrete për ta adresuar jo efikasitetin e gjyqësorit si: 1) ndryshimi i kuadrit ligjor, në mënyrë që gjyqësori të merret vetëm me rastet kur padia/ankesa është parashtruar nga palët, 2) parashikon një gjobë të reduktuar nëse gjoba paguhet brenda 72 orëve dhe e rritë gjobën nëse lënda shkon në gjykatë, 3) krijon një ekip prej 100 asistentë të cilët do t'i ndihmojnë gjyqtarët në uljen e numrit të lëndëve të vjetra gjatë një periudhe katërvjeçare dhe 4) ta mbajë normën pozitive në kryerjen e lëndëve me qëllim të zvogëlimit të numrit të lëndëve të vjetra duke e optimizuar sistemin e menaxhimit të lëndëve dhe me përdorimin e TIK-ut nëpër gjykata.

Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson se një kombinim i këtyre masave do të rezultojë në ulje drastike të kohës së zgjidhjes së lëndës nga 414 ditë sa është tani në 100 ditë.

Një plan për rishikimin e këtij fushe është në përputhje me qëllimin strategjik të Qeverisë së Republikës së Kosovës për anëtarësim në BE dhe përmbushjen e kërkesave të pranimit për një reformë intensive, efektive dhe të vazhdueshme të sektorit të drejtësisë. Qëllimi i këtyre reformave është harmonizimi i legjislacionit kombëtar me *Acquis* të BE-së dhe zbatimin e standardeve dhe praktikave më të mira të BE-së.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemimit kryesor

Kjo fushë është e rregulluar me Ligjin për Procedurën Kontestimore (LPK) më 20 shtator 2008 dhe gjykatat filluan ta zbatojnë më 6 tetor 2008. Ligji u bazua në Ligjin mbi Procedurën Kontestimore nga ish-Jugosllavia (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë 4/77, 36/80, 66/1982, 58/84, 74/87, 57/89, 20/90 dhe 35/91).

Puna për përgatitjen e një legjislacioni të tillë gjithëpërfshirës zakonisht kërkon kohë të mjaftueshme për analiza dhe për identifikimin e zbrastirave në ligjin ekzistues. Megjithatë, presioni për ta miratuar legjislacionin e ri kombëtar dhe për ta vendosur një sundim të ligjit sa më shpejt të jetë e mundur, çoi në krijimin e ligjeve që ishin "zgjidhje të shpejta" për problemet e ditës dhe jo efektive për përmbushjen e nevojave afatgjata. Disa hisedarë të intervistuar deklaruan se nuk kishte konsultim apo kontribut nga ana e tyre në këtë proces të hartimit të legjislacionit.

Vlen t'i përmendim disa përmirësime pozitive të sjella nga ky ligj, në krahasim me Ligjin e vjetër jugosllav: vetëm gjyqtarët profesionistë i vendosin lëndët (paneli i përbërë nga një gjyqtar profesional dhe dy gjyqtarët porotë i vendosin lëndët familjare); kërkesëpadia duhet t'i dërgohet të paditurit për përgjigje; duhet të zhvillohet seanca përgatitore, nuk lejohet futja e fakteve të reja në gjykimin e shkallës së dytë (vetëm një përjashtim), lëndët pushohen nëse të dyja palët nuk paraqiten në shqyrtimin paraprak ose kryesor; dënohen me gjobë palët dhe përfaqësuesit e tyre nëse e ofendojnë gjykatën ose nëse e pengojnë drejtësinë; dy baza të reja për aktgjykim - aktgjykimi për pranimin e kërkesëpadiisë dhe aktgjykimi i përkohshëm; dhe vendosja e afateve kohore për veprimet gjyqësore. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore nga viti 2012 nuk përfshinte ndryshime të rëndësishme në ligj. Amendamentet i kanë përmirësuar dispozitat për revizion, si mjet juridik të jashtëzakonshëm dhe i ka fshirë dispozitat për Arbitrazhin që janë futur në vitin 2008.

Pas gati dhjetë vjetësh të zbatimit të këtij ligji, ekziston një konsensus midis praktikuesve se ligji duhet të modernizohet. Gjetjet paraprake të tij do të ndahen në këto fusha :

- I. Fushat ku ligji duhet të harmonizohet me *Acquis* të BE-së dhe praktikat më të mira.
- II. Dispozitat ku nevojitet rishikimi dhe
- III. Sfidat me zbatimin e ligjit.

Fushat ku ligji duhet të harmonizohet me *Acquis* të BE-së dhe praktikat më të mira

Ligji aktual ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me legjislacionin e BE-së për çështjet që kanë të bëjnë me:

A.) Roli i Gjyqtarit në gjykimin e lëndëve

Në sistemin gjyqësor të Kosovës, gjyqtari merr një rol aktiv, inkuizitor, duke i këshilluar palët për të drejtat e tyre dhe duke i ndihmuar palët në mbledhjen e provave, përveç gjykimit të lëndës.

Në sistemin gjyqësor të Kosovës, barra e provës bie tek palët (neni 253 i LPK-së) Palët obligohen ti deklarojnë faktet në të cilat e bazojnë padinë dhe të paraqesin dëshmi të cilat i vërtetojnë këto fakte. Nëse padia është e pakompletuar dhe e pa mbështetur, pasi palët urdhërohen nga gjyqtari që ta përmirësojnë padinë, pas kalimit të afatit, gjykata e refuzon padinë si të pabazuar.

Disa prej këtyre janë karakteristika të sistemit adversial.

Por gjyqtari drejton dhe udhëheqë procedurën, cakton afatet, vendos në kërkesat/propozimet e palëve, vendos për angazhimin e ekspertëve, lejon dëshminë e dëshmitarëve, vendos për shtyrjen e seancave.

Ky është dallim i thellë me rolin e gjyqtarit në vendet e BE-së, të cilat kanë një sistem adversial ku gjyqtari është arbitri i çështjes dhe barra e provës qëndron tek palët dhe përfaqësuesit e tyre. Gjyqtarët vendosin lëndët në bazë të provave që i paraqesin palët.

B.) Gjyqtari aktualisht i kryen shumicën e detyrave administrative lidhur me lëndën

Sistemi i gjykatave nuk ka numër të mjaftueshëm të ndihmësve juridik të punësuar dhe të caktuar për të punuar me gjyqtarët. Si pasojë e kësaj gjyqtarët shpenzojnë kohë të konsiderueshme në administrimin e lëndëve.

Në vendet e BE-së dhe në vendet tjera të përparuara, gjyqtari ka një ekip të ndihmësve juridik dhe administrativ që e mbështetin në përpunimin e lëndëve. Kështu gjyqtarët shpenzojnë pjesën më të madhe të kohës në analizimin e lëndëve, shqyrtimin e provave të paraqitura dhe në konsultimin e dokumenteve ligjore relevante për gjykimin e lëndës. Rekomandimi i Këshillit të Ministrave (2010) 12 shtete

C.) Kohëzgjatja e procedurës

Mungesa e mbështetjes ligjore në shqyrtimin e lëndëve, mungesa e sistemit të menaxhimit të lëndëve në gjykata dhe e sistemit të informacionit, si dhe procesi i ngadaltë dhe joefikas i dërgimit të thirrjeve në mënyrë të konsiderueshme ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës. Angazhimi i palëve dhe i përfaqësuesve të tyre ligjor kanë një rol të rëndësishëm në lëvizjen e lëndëve përpara ose në vonimin e procedurave. Gjyqtarët që përballen me problemet e lartpërmendura në baza ditore zakonisht e miratojnë çdo kërkesë për shtyrjen e seancës. Shpejtësia e seancës fillestare të gjykatës varet shumë nga forma dhe përmbajtja e kërkesëpadisë së paraqitur. Është shumë e zakonshme që veprimi i parë i gjykatës është që ta kthejë kërkesëpadinë tek paditësi për ta shtuar dhe plotësuar.

D.) Ndërhyrja e Prokurorit Publik në lëndët civile

Ky mjet jashtëzakonshëm juridik është një mbetje e sistemit të vjetër komunist ku shteti përfshihej në lëndët civile.

Është rregull i përgjithshëm që shteti nuk ka interes dhe nuk duhet të ndërhyjë në kontestet civile midis dy palëve. Gjithashtu një parim i përgjithshëm është që çdo vendim i gjykatës të bëhet i formës së prerë dhe i përmbarueshëm, përveç nëse njëra prej palëve e apelon vendimin. E drejta e një qytetari për ta apeluar një vendim gjyqësor dhe administrativ rregullohet me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kështu, vendimi i formës së prerë i gjykatës civile nuk mund të kundërshtohet fare me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik.

Sfidat kryesore në përmbajtjen aktuale të ligjit përkitazi me:

- a) Dispozitat themelore nuk i përcaktojnë të gjitha rastet që rregullohen me këtë ligj. Legjislacioni krahasues në shumicën e vendeve të BE-së i përcakton të gjitha të drejtat që rregullohen dhe përpunohen me këtë ligj. (Cilat raste/të drejta rregullohen me këtë ligj në ato shtete?)
- b) Shqyrtimi përgatitor është e detyrueshme dhe konsiderohet si parakusht për mbajtjen e një shqyrtimit kryesor të rrjedhshëm/të pandërprerë¹ dhe krijimin e një afati kohor për përpunimin e mëtejshëm të rastit. Gjyqtarët zakonisht nuk e përdorin këtë instrument për ta lëvizur rastin përpara, në vend të kësaj ata i dërgojnë një kërkesëpadi të paditurit për përgjigje së bashku me ftesën në shqyrtimin kryesor.
- c) Dorëzimi i thirrjeve është një sfidë e madhe që ka ndikim të drejtpërdrejtë në kohëzgjatjen e procedurave. Ligji nuk e detyron paditësin që ta sigurojë adresën e të paditurit në

¹ Komiteti i Ministrave të KE-së ka deklaruar se "normalisht, procedura duhet të përbëhet jo më shumë se seanca dëgjimore, e para e cila mund të jetë një seancë paraprake e një natyre përgatitore dhe e dyta për marrjen e provave, dëgjimin e argumenteve dhe mundësinë e nxjerrjes së aktgjykimit. Gjykata duhet të sigurojë se të gjitha hapat e nevojshëm për seancën e dytë të merren në kohë, dhe në parim, nuk duhet të lejohet asnjë shtyrje, përveç kur paraqiten fakte të reja ose në rrethana të tjera të jashtëzakonshme dhe të rëndësishme", Parimi 1, Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës Rekomandimi nr. (84) 5, lidhur me parimet e Procedurës Civile të dizajnuara për ta përmirësuar funksionimin e Drejtësisë, i miratuar më 28 shkurt 1984 në takimin e 367-të të Zëvendësministrave

kërkesëpadi (nenet 253 dhe 99 të Ligjit). Burimet e gjykatës përdoren për të marrë informatat e tilla nga agjencia e autorizuar.

- d) Afatet procedurale për fazat e ndryshme të procedimit të rasteve janë parapa në ligjin aktual (nenet 400 par.4, 420 par.2) por këto afate parashihihen "si rregull" që do të thotë se mund të ketë shmangie nga këto afate. Koncepti i ekonomizimit të procedurës nënkupton që ligji/gjykata duhet të vendosë afate kohore për të ndërmarrë veprime procedurale dhe afate kohore për përfundimin e lëndës dhe rastet që nuk përfundohen brenda këtij afati të përcaktuar të konsiderohen si raste të vonuara. .

- e) Palët kanë nevojë për përfaqësim më të mirë ligjor në gjykatë

Megjithëse është e drejtë e palës që ta zgjedhë përfaqësuesin e vet, praktika tregon se palët që përfaqësohen nga avokatët kanë një normë më të mirë të suksesit.

- g) Pajtimi gjyqësor dhe zgjidhja alternative e kontestet ka një përdorim të kufizuar në gjykatat e Kosovës

Vetëm 2 për qind e lëndëve në gjykata zgjidhen me pajtim gjyqësor. Palët shumë rrallë pajtohen që të lënë procedurë gjyqësore për ta zgjidhur lëndën përmes ndërmjetësimit. Ligji për Ndërmjetësim u miratua në vitin 2008, por nuk u promovua e as zbatua sipas qëllimit të tij. Programi Vjetor i Qeverisë për vitin 2017 parasheh promovimin e formave të Zgjidhjes Alternative të Kontesteve si aktivitet i vazhdueshëm.

- i) Nuk ekziston një praktikë uniforme për shtyrjen e seancave apo vazhdimin e seancave të ndërprera.

Gjyqtarët japin vazhdim në baza *ad hoc*. Rekomandohet përgatitja e udhëzimeve dhe e kriterëve të gjykatave të brendshme për dhënien e vazhdimeve.

- j) Gjykata nuk e shpallë vendimin/aktgjykimin në fund të shqyrtimit kryesor.

Në vendet e BE-së gjyqtarët e shpallin vendimin e tyre në mbylljen e shqyrtimit kryesor. Në rastet më komplekse, gjyqtari i njofton palët për datën kur shpallet vendimi në seancë të veçantë. Shpallja e hershme e vendimeve është shumë e dobishme për palën e cila dëshiron të ankohe.

- k) Gjykata e Apelit i shfuqizon vendimet gjyqësore shumë herë.

Ekziston një praktikë e keqe që Gjykata e Apelit i shfuqizon vendimet e gjykatave disa herë para se të vendosë në bazë të meritave. Në vendet e BE-së, si dhe në Maqedoni, Gjykata e Apelit mund t'i kthejë lëndët vetëm një herë me një arsyetim të qartë dhe me udhëzime për gjyqtarin për ta mbajtur një gjykim të ri. Nëse vendimi i gjyqtarit të shkallës së parë është i njëjtë, gjykata e apelit e shqyrton ankesën, mbanë seancë dhe vendosë lëndën në bazë të meritës.

- l) Nuk ka prag për fillimin e revizionit në Gjykatën Supreme.

Praktikat më të mira të BE-së kanë vërtetuar se përveç kushteve të përgjithshme për paraqitjen e revizionit, kërkohet një prag minimal për ta lejuar revizionin. Në të njëjtën kohë, tarifa gjyqësore për paraqitjen e revizionit është shumë e lartë, gjë që i parandalon rastet që janë me vlerë të vogël dhe jo komplekse për të arritur në Gjykatën Supreme.

m) Pragu për raste komerciale dhe kërkesëpadi të vogla është shumë i ulët. Rritja e pragut prej 3.000 Euro në 10.000 Euro për rastet tregtare dhe nga 500 deri në 5.000 Euro² për kontestet e vogla do ta rrisë ndjeshëm numrin e rasteve që do të vendosen në procedurat e shkurtuara. Kjo zgjidhje do ta zvogëlojë në mënyrë drastike numrin e lëndëve të pazgjidhura pa e shkelur të drejtën themelore të palëve që kërkesëpaditë apo mbrojtjet e tyre të trajtohen me drejtësi.

n) Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore është në proces të rishikimit. Një pjesë e madhe e lëndëve të vjetra i përket kontesteve pronësore. Duke e pasur parasysh rëndësinë e kësaj të drejte dhe kompleksitetin e lëndëve të tilla, një zgjidhje e mundshme është krijimi i një divizioni të veçantë në gjykatë ku gjyqtarët do të merren vetëm me konteste pronësore.

Krijimi i një divizioni të veçantë i mundëson gjyqtarëve të merren vetëm me rastet pronësore kështu që ata do specializohen në këtë fushë duke gjykuar vetëm raste pronësore.

2.3 SFIDAT ME ZBATIMIN E LIGJIT

Ligji gjithashtu përballet me sfida të konsiderueshme në lidhje me zbatimin. Çështjet kryesore përfshijnë:

1. Procedura të gjata për shkak të menaxhimit të dobët të lëndëve
2. Lloje të ndryshme të lëndëve gjyqësore pronësore
3. Lëndët e vjetra
4. Numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve

1. Komuniteti ligjor, palët në procedura gjyqësore dhe shoqëria civile pajtohen se procedurat e tanishme të gjykatave civile zgjasin shumë gjatë në të gjitha shkallët e gjykatës. Sipas një sondazhi të kryer nga Projekti i USAID-it për të Drejtat Pronësore në shtator të vitit 2015,³ koha mesatare nga paraqitja e padisë e gjer në zgjidhje të një lënde pronësore është rreth 3.5 vjet (1289 ditë) dhe mesatarja është 3.31 vjet (1142 ditë). Gjithashtu, sipas sondazhit të kryer, deri në 80 për qind të lëndëve pronësore janë më të vjetra se 24 muaj, dhe lënda më e vjetër në pritje mund të arrijë mbi 20 vjet.

Problemi i menaxhimit të dobët të lëndëve është shumë i zakonshëm në vendet me sistem të ligjit civil dhe të mirënjohur në vendet e Ballkanit Perëndimor. Neni 10 i Ligjit për Procedurën Kontestimore parasheh që "gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji". Megjithatë, gjyqtarët të cilët janë përgjegjës për përpunimin e lëndëve civile nuk i përmbahen këtij instituti të ekonomizimit të procedurës. Analiza e studimit të lëndëve të mbyllura tregoi se shumë faktorë kontribuan në një procedim të gjatë si në vijim: lëndët nuk i nënshtroheshin shqyrtimit të hershëm; kërkesëpadia nuk i është dërguar të paditurit për përgjigje; shqyrtimi përgatitor nuk u mbajt ose nuk u mbajt në të gjitha kushtet e kërkuara; koha e kaluar midis dy veprimeve; dhënia e vazhdimeve; mbajtja e shumë seancave gjyqësore dhe shumë të tjerë.

² PE 539 630; Procedura Evropiane për Kërkesëpadi të Vogla

³ Menaxhimi i rrjedhës së lëndëve për lëndët e të drejtave pronësore në gjykatat themelore, shtator 2015

Megjithëse analiza të tilla nuk janë bërë për lëndët tjera civile, mund të supozohet, bazuar në të dhënat nga Kroacia dhe Serbia, procedurat në këto lëndë zgjasin njëjtë ose edhe më gjatë (p.sh. kontratat, komercialet).

Në shumicën e vendeve të zhvilluara, ka kufizime të rrepta në kohën e procedimit të lëndëve për të siguruar se drejtësia ndahet me kohë. Sipas Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), “në vendet anëtare të BE-së, procedimi i çdo lënde civile që zgjatë më shumë se dy vjet në nivel gjykate konsiderohet shkelje e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ka të bëjë me të drejtën për gjykim në kohë të arsyeshme. Gjykata mund të ndryshojë nga rregulli i përgjithshëm në lëndët civile me prioritet (lëndët e punës dhe familjes) dhe të konstatojë shkelje nëse procedura zgjatë më pak se dy vjet”.

Standardi kohor i vendosjes së lëndëve civile në gjykatat amerikane sillet nga tre muaj deri në maksimum një vit.

2. Ky problem rrjedh nga sfondi unik juridik, socio-politik dhe ekonomik i Kosovës. Nuk ka përkufizim të qartë të llojeve të pronave; zgjidhja e një statusi ligjor të një toke ndërtimi në zonat urbane; qiraja e tokës për 99 vjet dhe sqarimi i të drejtave pronësore të të huajve në Kosovë⁴. Në vendet e BE-së, të drejtat pronësore janë të përcaktuara qartë në Ligjin për të drejtat pronësore dhe transferimi i pronës rregullohet me Ligjin për kontratat. Këto çështje duhet të adresohen në rishikimin e ardhshëm të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore⁵. Një pjesë e rëndësishme e lëndëve të pazgjidhura gjyqësore është krijuar nga përpunimi i gjatë i të drejtave të pronësisë. Ka shumë lëndë pronësore që janë në pritje dhe gjyqtarët nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim për muaj, madje edhe vite.
3. Lëndët e vjetra civile kanë qenë problem i vazhdueshëm në gjykatat e Kosovës. Gjykatat kanë trashëguar një numër të madh të lëndëve të vjetra nga gjykatat që vepronin sipas Ligjit të vjetër për Procedurën Kontestimore. Gjyqësori është i mbingarkuar për shkak të grumbullimit të lëndëve nga dekadat e fundit dhe kundërvajtjeve të vogla⁶. Që nga miratimi i Ligjit për Procedurën Kontestimore në vitin 2008, janë bërë përpjekje të shumta për t'i zhvilluar rrugët e përpunimit të lëndëve dhe masat për ta zvogëluar numrin e lëndëve të vjetra. Që nga viti 2014, gjykatat nuk kanë juridiksion për t'i përmbuar vendimet gjyqësore, por një numër i lëndëve të pazgjidhura janë në barrë të gjykatave.
4. Ka pasur diskutim të vazhdueshëm nëse sistemi gjyqësor i Kosovës nuk ka numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve⁷ ose nëse ekziston nevoja për specializim të mëtejshëm të gjyqtarëve aktual dhe krijimin e një kurrikule gjithëpërfshirëse për arsimim të vazhdueshëm.

Sistemi gjyqësor aktualisht ka dyqind gjyqtarë më shumë sesa që ishin të pranishëm në ish Jugosllavi dhe vazhdon të rritet në baza vjetore.

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, ka pasur një tendencë në të gjitha vendet e reja të pavarura për ta zgjedhur një numër të madh të gjyqtarëve të ri pa ndonjë analizë gjithëpërfshirëse të kërkesës aktuale për gjyqtarë të ri. Arsyeja kryesore për ta mbështetur këtë vendim ishte zvogëlimi i numrit të lëndëve ekzistuese të vjetra, në vend

⁴ Koncept notë për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore

⁵ Ligji Nr 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, 25 qershor 2009

⁶ Strategjia Kombëtare e Zhvillimit (2016-2021)

⁷ Nevoja për të dhëna empirike për ta mbështetur këtë deklaratë

që të fokusoheshin në çështje si: a) përmirësimi i statusit të gjyqtarëve⁸ b) punësimi i bashkëpunëtorëve profesional për ta mbështetur punën e gjyqtarëve; c) prezantimi i sistemit për menaxhimin e lëndëve gjyqësore dhe sistemin e informacionit; dhe d) trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve për legjislacionin e ri (ligjet materiale dhe procedurale). Sllovenia ka numrin më të madh të gjyqtarëve në Evropë. Kroacia, Serbia dhe Maqedonia⁹ janë pranë Sllovenisë me shumicën e gjyqtarëve për kokë banori në Evropë. Megjithatë këto vende kanë më shumë se tre herë gjyqtarë krahasuar me vendet e tjera evropiane, ato ende kanë një numër të madh të lëndëve të vjetra dhe nuk e kanë arritur qëllimin fillestar të reduktimit të lëndëve të vjetra.

Ligjet dhe Aktet nënligjore

Ligji për procedurën jokontestimore¹⁰ i përcakton rregullat mbi të cilat gjykatat vendosin lëndët në lidhje me të drejtat personale, familjare, pronësore dhe interesa tjera ligjore.

- Ligji për Gjykatat¹¹ e rregullon organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e gjykatave në Republikën e Kosovës
- Ligji për ndërmjetësimin¹² e rregullon procedurën e ndërmjetësimit në përgjithësi, themelimin, organizimin, funksionimin e Komisionit të Ndërmjetësimit, si dhe të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e ndërmjetësuesve.
- Ligjin për Këshillin Gjyqësor¹³ e rregullon organizimin dhe funksionet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) duke i përfshirë procedurat për rekrutim, emërim, riemërim, transferime, disiplinë, vlerësim, ngritje në detyrë dhe trajnim të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë; menaxhimin dhe administrimin e gjykatave, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të gjyqësorit; dhe themelimin e gjykatave dhe degëve të reja.
- Ligji për noterinë¹⁴ e rregullon organizimi dhe funksionimi i noterisë si veprimtari publike në Kosovë, kushtet dhe metodat e punës si dhe çështje tjera me rëndësi për ushtrimin e detyrës së noterit.
- Ligji për Procedurën Përmbarimore¹⁵ i parashkruan rregullat për procedurën e përmbarimit në të cilin gjykatat dhe përmbaruesit privat i përcaktojnë dhe e realizojnë përmbarimin në bazë të titujve përmbarues dhe dokumenteve autentike, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe.

⁸ Karta Universale e Gjyqtarëve (e miratuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtarëve më 17 nëntor 1999, <https://www.domstol.dk/om/otherlanguages/english/publications/Publications/The%20universal%20charter%20of%20the%20judge.pdf>)

⁹ Studimi CEPEJ nr. 23 - Sistemet gjyqësore Evropiane, efikasiteti dhe cilësia e drejtësisë, faqe 91 - Kroacia ka 1734 gjyqtarë profesionistë ose 41 gjyqtarë për 100,000 qytetarë, Sllovenia ka 924 gjyqtarë ose 45 për 100,000 qytetarë, Serbia ka 2700 gjyqtarë ose 38 gjyqtarë për 100,000 qytetarë dhe Maqedonia ka 629 gjyqtarë ose 30 gjyqtarë për 100,000 qytetarë. Numri mesatar i gjyqtarëve në dyzetegjashtë vendet e vlerësuara është 21 dhe mesatarja 18.

¹⁰ Ligji nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore, 20 nëntor 2008

¹¹ Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat i miratuar më 1 janar 2011 dhe hyri në fuqi më 1 janar 2013 dhe Ligji nr. 05/L-032 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat, 28 maj 2015

¹² Ligji nr. 03/L-57 për ndërmjetësimin, 18 shtator 2008

¹³ Ligji nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor, 30 shtator 2010; 05/L-033 për Këshillin Gjyqësor, 28 maj 2015 dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-094 për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-033 dhe Ligjit nr. 04/L-115 për Këshillin Gjyqësor, 26 Mars 2016

¹⁴ Ligji nr. 03/L-10 për Noterinë Publike, 17 tetor 2010 dhe Ligji nr. 04/L-002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për noterinë, 21 korrik 2011

¹⁵ Ligji nr. 04/L-139 për procedurën përmbarimore, 20 dhjetor 2012 dhe Ligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën përmbarimore, 18 prill 2017

- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve,
- Ligji nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore
- Ligji për Zgjidhjen e Konfliktit të Ligjeve
- Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të Gjykatave¹⁶ përcakton organizimin, menaxhimin dhe punën e gjykatave në Republikën e Kosovës
- Rregullorja për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve¹⁷ i përcakton kriteret dhe rregulloret për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve që janë bazë për avancimin ose uljen në karrierë, duke e përfshirë shkarkimin e gjyqtarit, si dhe mandatin dhe punën e komisionit vlerësues.
- Plani i balancuar për gjykim të lëndëve civile (që e zëvendëson Rregulloren për përcaktimin e normave të punës së gjyqtarëve)

PËRVOJAT NGA VENDET TJERA

KROACIA

Teksti i integruar i Ligjit për Procedurën Kontestimore (Narodne Novine nr.148/2011) përfshinë ligjin origjinal për Procedurën Kontestimore nga RSFJ-ja i vitit 1977 dhe ndryshimet pasuese në vitin 1980, 81/82/84/87/1990 1991, 1993,1999, 2003, 2005, 2008 dhe 2011).

Risitë kryesore në rishikimin e fundit të ligjit janë si në vijim: ndarja e kompetencave në mes të komunës dhe gjykatave ekonomike në rastet e punës dhe falimentimit; gjykata ex officio vendosë për audio regjistrim; gjyqtari i këshillon palët për zgjidhjen e rasteve nëpërmjet ndërmjetësimit; pala mund ta tërheqë kërkesën e saj edhe pas përfundimit të shqyrtimit kryesor; pajtimi gjyqësor mund të arrihet derisa ekziston procedura në gjykatën e apelit; dispozitat në lidhje me përmbajtjen dhe dorëzimin e kërkesëpadisë janë më të forta; gjykata e apelit mund të vendosë mbi meritat edhe pse vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka defekte të vogla dhe pragu për rishikimin e lëndës është deri në 28,600 euro dhe në rastet ekonomike nuk mund të jetë më i lartë se 71,500 euro.

Vendi nuk i ka ndryshuar parimet bazë dhe institutet e Ligjit të vjetër federal për procedurën kontestimore të Jugosllavisë. Kohëzgjatja e procedurës është shumë më e gjatë sesa standardet e BE-së dhe sistemi gjyqësor i ka 520.000¹⁸ lëndë të vjetra. Ky sistem gjyqësor është i dyti në Evropë për kah numri i gjyqtarëve (pas Sllovenisë), por është shumë joefikas.

Edhe pse ka një rënie të numrit të kërkesave të dorëzuara pranë GJEDNJ-së në Strasburg për shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga viti 2014-2017, numri i aktgjykimeve kundër Kroacisë është rritur nga 33 në vitin 2014 në 39 në vitin 2016.

¹⁶ Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të Gjykatave, që nga 4 janari i vitit 2013 dhe anekset nga 22 shkurti 2013 dhe 7 dhjetori 2016

¹⁷

¹⁸ Raporti i Kroacisë për të Drejtat e Njeriut 2016

MAQEDONIA

Ligji për Procedurën Kontestimore u miratua në vitin 2005 (Gazeta Zyrtare 79/2005). Ky ligj u modernizua dhe u harmonizua me *acquis* të BE-së dhe me praktikat më të mira. Ky ligj paraqiti një sistem kundërshtar në lëndët civile. Gjyqtari është arbitër dhe palët janë përgjegjëse për ta dëshmuar rastin në gjykatë. Sistemi i ri i ka forcuar dispozitat e mëposhtme: juridiksioni i gjykatës; afatet kohore për çdo veprim gjyqësor; dorëzimi i thirrjeve; përfaqësimi ligjor i palëve; provat e paraqitura me kërkesëpadi; marrja e provave *ex officio* me përjashtim; seanca përgatitore e detyrueshme; gjoba për pengimin e drejtësisë. Përveç kësaj gjykata e apelit mund ta kthejë rastin në gjykatën e shkallës së parë vetëm një herë dhe herën e dytë duhet të vendosë në bazë të meritave. Ligji gjithashtu përcakton se procedura në gjykatën e shkallës së dytë duhet të përfundojë brenda gjashtë muajve dhe në Gjykatën Supreme brenda tetë muajve nga fillimi i procedurës.

Së bashku me ndryshimin e procedurës civile, shumë nga kompetencat gjyqësore në fushën civile u transferuan tek profesionistët ligjorë jashtë gjykatës. Noterët publik vendosin për rastet e pakontestuar të trashëgimisë dhe i lëshojnë urdhërpagesat. Përmbaruesit privat janë përgjegjës për t'i përmbaruar vendimet civile, për t'i dorëzuar thirrjet gjyqësore sipas kërkesës dhe për t'i vërtetuar faktet, të cilat gjykata mund t'i përdorë në procedurë. Reforma e vërtetë në procedurat gjyqësore ka ndodhur pas futjes së Sistemit të Menaxhimit të Rrjedhës së Lëndës në vitin 2005 (së pari në 10 gjykata pilot dhe më pas u shtrua në të gjitha 27 gjykatat) dhe me krijimin dhe zbatimin e Sistemit të Automatizuar për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (ACCMIS).

Gjatësia e procedurave civile në gjykatat maqedonase është relativisht e shkurtër. Sistemi gjyqësor ende ka një numër të vogël të lëndëve të vjetra, por problemet e gjykimit në kohë të arsyeshme në ditët e sotme janë tejkaluar.

Nxjtja kryesore për ta ndryshuar këtë ligj procedural ishte numri i madh i kërkesave (384) kundër Maqedonisë për shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Struktura e gjykatës përbëhet nga gjykata me juridiksion të përgjithshëm dhe nga gjykata administrative. Janë 27 gjykata, 4 gjykata apeli dhe Gjykata Supreme. Gjykata Administrative vendosë për kontestet administrative në shkallë të parë dhe Gjykata e Lartë Administrative vendosë për ankesën për vendimet e Gjykatës Administrative.

SERBIA

Ligji më i ri për Procedurën Kontestimore në Serbi është aprovuar në vitin 2011 (Gazeta Zyrtare e RS nr.72/2011 dhe e zëvendësoi Ligjin mbi Procedurën Kontestimore nga viti 2004. Ligji i ri e përcakton një kohë të arsyeshme për gjykim, i forcon dispozitat lidhur me disiplinën procedurale dhe e ndalon keqpërdorimin e të drejtave procedurale. Ligji paraqet afate kohore për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara, të cilat përfshijnë pjesëmarrjen aktive të palëve dhe të gjyqtarit. Nëse gjyqtari nuk e respekton këtë rregull, kundër tij mund të nisët procedura disiplinore.

Afati kohor për zgjidhjen e kontestit civil është dy vjet dhe është parashikuar korniza kohore më e shkurtër për zgjidhjen e rasteve komerciale, familjare dhe të punës që i nënshtrohen procedurave të ndara.

Gjykata e ndalon dorëzimin e shkresave në seancë. Shkresat që gjykata i merr 15 ditë para seancës dëgjimore pranohen dhe kjo i pengon palët që të kërkojnë shtyrjen. Kushtet për shtyrje kufizohen vetëm në mungesën e gjyqtarit ose nëse kërkohet kohë për marrjen e

provave të mëtejshme. Gjykata lëshon një vendim për ta caktuar një seancë brenda afateve kohore të parashikuara në ligj. Nëse pala ankohe ndaj një vendimi pasi gjykata e apelit ka anuluar tashmë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, gjykata e apelit detyrohet që ta vendosë lëndën në bazë të meritave.

U prezantuan dy procedura të reja të veçanta: një procedurë në rastet e shërbimit për klientë dhe një procedurë për mbrojtjen e të drejtave kolektive dhe të interesave të qytetarëve.

Risitë e paraqitura në Amendamentet e Ligjit për Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare nr. 49 /2013) janë si më poshtë: një gjyqtar i vetëm vendosë për lëndët komerciale, qiramarrësit, shkeljet e pronës, të drejtat e autorit, rastet kolektive dhe ndihmat juridike; përfaqësuesi ligjor i palës nuk ka nevojë që të jetë jurist dhe në lëndët e punës, përfaqësuesi i Sindikatës mund ta përfaqësojë palën.

Pala detyrohet që t'ia paraqesë gjykatës adresën e palës tjetër të cilës duhet t'i dërgohen shkresat ose thirrja. Nëse shkresat nuk mund të dorëzohen në atë adresë, gjykata e merr ex officio adresën e re nga agjencia e autorizuar. Janë dy kushte tjera në të cilat lejohet rishikimi: a) nëse gjykata e apelit e ndryshon vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe b) nëse gjykata e apelit e pranon ankesën, e shfuqizon vendimin dhe vendosë në bazë të meritës. Pragu për rishikimin e lëndët në fushën tregtare është deri në 100,000 euro dhe në rastet pronësore jo më shumë se 40,000 euro.

Këto rishikime të reja të ligjit e kanë forcuar procedurën, por nuk e kanë ndryshuar natyrën e saj të përgjithshme. Gjyqtari ende ka rol të rëndësishëm si hetues në këtë rast. Ai i mbledhë provat ex officio, gjë që e zgjatë kohëzgjatjen e procedurës. Barra në rritje e punës në tre vitet e fundit, së bashku me grumbullimin e madh të lëndëve të vjetra, e ka penguar gjykatën që të gjkojë në kohë të arsyeshme për qytetarët. Kjo është arsyeja pse Serbia ka një numër të madh të lëndëve të pazgjidhura në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg (KEDNJ). Gjykata i trajtoi 1,286 kërkesa në lidhje me Serbinë në 2016, nga të cilat 1,220 u shpallën të papranueshme ose u përjashtuan. Ajo i nxori 21 aktgjykime (në lidhje me 66 kërkesa), 19 prej të cilave kanë gjetur të paktën një shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

SUEDIA

Suedia i përket vendeve me traditë të së drejtën civile. Ndikimi ligjor romano-gjerman njihet për varësinë nga ligjet dhe kodet.

Struktura e gjykatës përbëhet nga gjykata me juridiksion të përgjithshëm, gjykata administrative dhe tri gjykata të specializuara.

Gjykatat e përgjithshme janë të organizuara në dyzet e tetë gjykata të qarkut, katër gjykata të apelit dhe Gjykata Supreme.

Gjykatat administrative janë të organizuara në tri nivele: dymbëdhjetë gjykata administrative të qarkut, katër gjykata administrative të apelit dhe Gjykata e Lartë Administrative.

Gjykatat e specializuara janë themeluar për tri lloje të lëndëve: Gjykata e Punës, e Tregut dhe e Apelit për Patenta.

Procedura civile fillon me dorëzimin e kërkesës në gjykata. Ka shumë udhëzime të detajuara për përmbajtjen e kërkesës dhe një formë në dispozicion për t'u plotësuar në internet. Në këtë formë, paditësi duhet të deklarojë qartë se çfarë kërkon nga i padituri dhe t'i përfshijë të

gjitha dëshmitë me shkrim në dy kopje të vërtetuara. Paditësi gjithmonë e dorëzon kërkesën së bashku me certifikatën e lindjes. Gjykata i dërgon thirrje të paditurit me udhëzim të qartë për përgjigje.

Pas marrjes së përgjigjes, gjyqtari e planifikon një seancë përgatitore ku të gjitha çështjet diskutohen nën mbikëqyrjen e gjyqtarit. Ndonjëherë rasti mund të zgjidhet në këtë fazë dhe aktgjykimi shqiptohet në vend. Nëse rasti nuk përfundohet në seancën përgatitore, gjyqtari e cakton shqyrtimin kryesor. Palët i paraqesin të gjitha provat dhe argumentet e tyre në gjykatë dhe një panel prej tre gjyqtarësh profesional e merr vendimin.

Ankesa ndaj vendimit të shkallës së parë lejohet brenda tre javëve nga shpallja e vendimit. Gjyqtari i apelit kryen shqyrtimin fillestar të ankesës dhe paraqet gjetjet e tij para kolegjit prej tre deri në katër gjyqtarësh. Nëse ka dëshmi të mjaftueshme që vendimi i ankimuar duhet të shqyrtohet, ky panel jep një të ashtuquajtur "leje për apel". Kjo do të thotë se ankesa mund të procedohet më tej. Në shumicën e rasteve, gjykata e apelit vendos pa e dëgjuar rastin. Në rastet kur dëshmia e re (me përjashtim) paraqitet në ankesë, gjykata e hapë lëndën, i dëgjon të gjitha dëshmitë dhe vendosë në bazë të meritave.

Të drejtat pronësore - Suedia

Reforma e sistemit gjyqësor në vitin 2011 rezultoi me krijimin e pesë gjykatave të tokës dhe mjedisit. Para kësaj reforme, të drejtat pronësore dhe mjedisore procedoheshin nga dy gjykata të specializuara. Gjykatat e tokës dhe ato të mjedisit i zgjidhin lëndët e kontestuara për regjistrimin e pronës, ndërtimin dhe servitutet e komunaleve, shpronësimin, lejet për operimin e ujësjellësit, çështjet e ndërtimit, planifikimin dhe rrënimin, rastet e qiradhënies së pronës dhe ankesat rreth çështjeve të planifikimit.

Ekzistojnë tri mënyra për ta iniciuar një lëndë në këtë gjykatë: kërkesa për thirrje në seancë, kërkesa për ta marrë lejen për ujësjellës ose për punë që janë të dëmshme për mjedisin, dhe ankesa ndaj vendimit të gjykatës së rrethit ose autoritetit administrativ.

Këto lloje të lëndëve trajtohen nga një gjyqtar i vetëm, i cili ndihmohet nga një këshilltar teknik. Këshilltari teknik është një punonjës i gjykatës dhe ka ekspertizë shkencore në atë fushë specifike.

HOLANDA

Sistemi i së drejtës civile në Holandë rrjedhë nga sistemi romano-gjerman, ku gjyqtarët i zbatojnë kodet dhe ligjet e shkruara në secilin rast individual.

Ligji Holandez Civil është i ndarë në tri fusha:

- Ligji për personat (që e përfshinë ligjin për familjen, ligjin për trashëgiminë dhe ligjin për shoqëritë tregtare);
- Ligji i pronës (që e përfshinë ligjin e të drejtave të pronës së patundshme, ligjin e detyrimeve, të drejtën e kontratës, të drejtën komerciale dhe ligjin e punësimit);
- Ligji i pronës intelektuale (që e përfshinë ligjin për patentat, të drejtat e autorit, markat tregtare dhe emrat tregtar).

Të gjitha rastet civile në nivelin e gjykatës së qarkut vendosen nga një gjyqtar i vetëm. Gjyqtari nuk duhet ta ketë ndonjë specializim në ndonjë fushë të caktuar civile, por vendosë për rastet në të tre fushat e lartpërmendura.

Në rastet më komplekse civile/komerciale, gjyqtari mund t'ia referojë rastin një kolegji prej tre gjyqtarëve profesionistë. Secila Gjykatë e Qarkut i ka disa nga këto panele - të

ashtuquajtura “dhoma” ku tre gjyqtarë vendosin bashkërisht për kontestet nën kryesinë e një zëvendëskryetari të kolegjit.

Sistemi gjyqësor i ka tre nivele - 19 gjykata të qarkut (50 gjykata nën-qarkore), 4 gjykata apeli dhe Gjykata Supreme.

Gjykatat e nën-qarkut mund t’i zgjidhin pretendimet ku vlera e rastit nuk kalon 25,000 euro.

Procesi gjyqësor fillon me një thirrje që e përmban kërkesëpadinë dhe bazën e saj. Përmbartuesi privat¹⁹ ia dorëzon thirrjen të paditurit dhe i kërkon që të paraqitet në gjykatë në datën e caktuar. Përfaqësimi nga avokati është i detyrueshëm²⁰. Barra e provës vihet mbi paditësin dhe ai gjithashtu e bartë rrezikun e ofrimit të provave të pamjaftueshme gjykatës (i ashtuquajtur i rrezik i provave). I padituri nuk e bartë barrën e provës dhe është i detyruar vetëm t’i ofrojë gjykatës kundër prova të mjaftueshme. I padituri duhet ta paraqesë dëshminë me shkrim ose ta paraqesë atë në seancën dëgjimore. Kodi Holandez i Procedurave Civile përfshinë rregulla për provat civile (duke përfshirë edhe mënyrën se si vlerësohen dhe si duhet të mbledhen provat).

Ligji në vitin 2002 e paraqiti rregullin se të gjitha dëshmitë (regjistrimet në kasetë, raportet mjeko-ligjore, dokumentet e shkruara) duhet të paraqiten në gjykatë dhe të përdoren si të tilla. Edhe provat që janë vjedhur apo mbledhur gabimisht në shumicën e rasteve (por jo gjithmonë) lejohen në gjykatë si dëshmi.

Gjykata mund ta mbështesë aktgjykimin e saj vetëm në faktet që janë paraqitur dhe janë dëshmuar në seanca nga cilado palë. Gjykata është pasive dhe asaj nuk i lejohej që ta bazojë aktgjykimin në prova të cilat nuk janë paraqitur nga ndonjëra palë.

Pas dëgjimit, gjyqtari e nxjerrë vendimin. Ky vendim mund të jetë subjekt i apelit. Vendimi për meritat zakonisht zgjatë nga gjashtë deri në dymbëdhjetë muaj.

I padituri duhet të paraqitet në seancë me përfaqësues ligjor (kjo është kërkesë procedurale). Nëse i padituri thirret në mënyrë të duhur dhe nuk paraqitet në gjykatë ose shfaqet pa avokat, gjykata duhet ta lëshojë një aktgjykim për mospërmbushje. Gjykata gjithashtu do të lëshojë aktgjykimin për mos përmbushje në rastet kur i padituri është njoftuar se është i detyruar që ta paguajë tarifën e gjykatës por nuk e ka bërë.

I padituri ka të drejtë paraqes te prapësim pas lëshimit të aktgjyimit në mungesë. I padituri në këtë rast ia dorëzon shkresat e thirrjes/prapësimin paditësit. Prapësimi në këtë rast konsiderohen si deklaratë e mbrojtjes dhe mund ta përmbajnë kundërshtim. Kundërshtimi mund të bëhet brenda 30 ditëve nga marrja e aktgjyimit në mungesë. Nëse i padituri nuk banon në Holandë, ai i ka 60 ditë për ta dorëzuar kundërshtimin.


Procedurat e shkurtra përdoren shpesh në rastet civile. Në lëndët urgjente, avokati i një pale mund të kërkojë nga kryetari i gjykatës (gjyqtari paraprak) që ta caktojë një datë në të cilën mbahet seanca paraprake. Paditësi duhet ta njoftojë të paditurin për datën e seancës me shkresat e thirrjes. Një seancë zakonisht planifikohet midis një deri gjashtë javë pas kërkesës së datës. Të dyja palët mund të paraqesin dëshmi në gjykatë deri në 24 orë para dëgjimit. Si rregull, paditësi duhet të paraqitet para kryetarit të gjykatës të shoqëruar nga avokati. Natyra e kësaj seance është joformale dhe të dyja palëve dhe avokatëve të tyre u jepet mundësia që rastet e tyre të paraqiten me gojë. Kryetari i gjykatës mund t’u bëjë palëve ose përfaqësuesve të tyre sa pyetje që dëshiron dhe ta përfundojë seancën dëgjimore. Gjyqtari e

¹⁹ Thirrjet gjyqësore dorëzohen përmes përmbartuesve privatë. Dorëzimi është pothuajse 100% efektiv

²⁰ The dispute resolution Review Law Business Research Fifth Edition Editor Richard Clark, 2013

shpallë vendimin brenda shtatë deri në katërmëdhjetë ditëve dhe e përgatitë vendimin e shkruar disa ditë më vonë. Aktgjykimi në procedurat e shkurtra nuk ndikon në pozicionin ose të drejtat e ndonjëres prej palëve në procedurën e meritës (për të njëjtën temë).

Aktgjykimi në procedurën e shkurtër mund të apelohej brenda katër javëve pas pranimit. Të dyja palët detyrohen që t'i dorëzojnë deklaratat me shkrim në gjykatë dhe të paraqiten para gjykatës me avokatët e tyre. Në çështjet urgjente, Gjykata e Apelit mund ta vendosë këtë ankesë brenda dy javëve. Vendimi i gjykatës së apelit mund të apelohej në Gjykatën Supreme brenda tetë javëve.



Procedurat civile në gjykatat holandeze zgjasin më pak se dy vjet në nivel gjykate, që është në përputhje me standardet e Komisionit Evropian për efikasitetin e drejtësisë (CEPEJ).

Tabela 1 - Vendet e rajonit

Vendi	Kosova	BeH	Serbia
Ligji/rregullorja	Ligji për procedurën kontestimore	Kodi i Procedurës Civile ²¹	Ligji për procedurën civile ²²
Miratohet LPK	2008	2003	2011
Dispozitat themelore i përcaktojnë llojet e të drejtave të mbrojtura me këtë ligj	Jo	Po	Po Neni 2
Gjykimi e lëndës/ gjyqtari i vetëm ose paneli me gjyqtarë porotë	Gjyqtari profesional/ paneli me porotë vetëm në lëndët familjare dhe ato me të mitur	Gjyqtar profesional; Paneli me gjyqtarë porotë	Gjyqtar profesional; Paneli me gjyqtarë porotë Neni 35
Përmbajtja e detyrueshme e kërkesëpadisë	Po Neni 253	Po Neni 53	Po Neni 98
Taksa gjyqësore paguhet me parashitje	Jo	Po	Po
Përgjigja ndaj kërkesëpadisë/ e detyrueshme	Neni 395	Po Neni 70	Po Neni 297
Mënyra e dorëzimit të thirrjeve	Gjykata, posta dhe dërgimi elektronik Neni 103	Post, punonjësi i gjykatës Neni 337	Gjykata, posta, postë rekomande dhe e-mail
Menaxhimin e lëndës		Lënda përfundon në dy seanca dëgjimore Neni 10-11	Neni 10
Vendimi	Neni 166,2	Neni 60(3 -5)	Nenet 203, 294 dhe 359

²¹ <http://www.advokat-prnjavorac.com>

²² <http://www.seio.gov.rs/upload/documents/ekspertske%20misije/Judicial%20Reform/Civil%20Procedure%20Code/Civil%20procedure%20Code.pdf>

²³ www.legislationline.org/documents/id/17967

përfundimtar <i>Res Judicata</i>		Neni 67(4)	
Shqyrtimi përgatitor	Jo Neni 400	I detyrueshëm Neni 75	I detyrueshëm Neni 302
Shqyrtimi kryesor/urdhri për shqyrtim	Po Neni 425	Neni 97	Po Neni 310
Vazhdimet	Nenet 438,1-4	Nenet 111-112	Nenet 329-331
Provat	Nenet 7 dhe 319	Neni 8	Palët propozojnë dhe vërtetojnë dëshmitë, Neni 228 dhe Gjykata kërkon prova Neni 262
Shpallet vendimi i shkallës së parë	Pesëmbëdhjetë ditë pas mbylljes së shqyrtimit kryesor Neni 203	Në seancë të veçantë Neni 185	Në shqyrtimin kryesor Neni 352 dhe 363 ose në një shqyrtim të veçantë brenda tetë ditëve nga shqyrtimi kryesor Neni 319 (2)
Përgatitet vendimi me shkrim	Neni 153	Përgatitet brenda 30 ditëve nga shpallja Neni 184	Vendimi përgatitet brenda tetë ditëve ose në raste më komplekse brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga shpallja Neni 354
Ankesa/përmbajtja e detyrueshme	Po Neni 178	Po. Neni 205	Po Nenet 98 dhe 370
Mjetet e jashtëzakonshme juridike	Revizioni Nenet 211-231; përsëritja e procedurës, Nenet 232-241; marrëdhënia ndërmjet propozimit për përsëritjen e procedurës dhe revizionit, Nenet 242-244 dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, Nenet 245-251	Revizioni Neni 237 dhe rihapja e procedurës Neni 255	Revizioni Neni 403; Përsëritja e procedurës Neni 426; dhe marrëdhënia midis propozimit për përsëritjen e procedurës dhe revizionit Neni 434
Ndërmjetësimi	Gjykata e referon palën në ndërmjetësim Neni 411,1	Gjykata e referon palën në ndërmjetësim Neni 86	Gjykata e referon palën në ndërmjetësim Neni 12; Palët bien dakord që ta zgjidhin kontestet me ndërmjetësim, Nenet 192 dhe 342

Procedurat e veçanta	Kontestet në marrëdhëniet e punës Nenet 474-477; Kontestet për pengimin e posedimit Nenet 478-483; Procedura e kontesteve të vogla Nenet 484-491 Lëshimi i urdhërpagesës Nenet 492-504; Kontestet tregtare Nenet 505-510	Kontestet në marrëdhëniet e punës Nenet 419-422; Procedura për hyrje pa leje Neni 423-427; dhe kontestet e vogla Nenet 428-433	Kontestet në marrëdhëniet e punës Nenet 436-441; Kontestet për marrëveshje kolektive Nenet 443-447; Kontestet për pengimin e posedimit Nenet 448-454; Lëshimi i urdhërpagesës Nenet 455-466; Procedurë e kontesteve të vogla Nenet 467-479; Kontestet tregtare Nenet 480-487; Procedura për kontestet e konsumatorëve Nenet 488-493 dhe Procedura për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive Nenet 494-505

TABELA 2 - VENDET E BE-SË

	Rumania	Bullgaria	Sllovenia	Gjermania	Letonia
Ligji/rregullorja	Kodi i Procedurës Civile ²⁴	Procedura Penale Kodi ²⁵	Ligji për procedurën civile ²⁶	Kodi i Procedurës Civile ²⁷	Ligji civil ²⁸
Miratohet LPK	Shkurt 2013	Mars 2008	2004	2005	2014
Dispozitat themelore i përcaktojnë llojet e të drejtave të mbrojtura me këtë ligj	Jo	Jo	Po Neni 1	Jo	Është thënë në hyrje (1-25)
Gjykimi e lëndës/gjyqtari i vetëm ose paneli me gjyqtarë porotë	Gjyqtari profesional, kolegji i gjykatës Neni 50	Gjyqtar profesional/pa gjyqtarë porotë	Gjyqtar profesional	Gjyqtar i vetëm; Kryetari i trupit gjykues për lëndët tregtare Nenet 348 a dhe 349	Gjyqtari i vetëm Neni 12 (1)
Përmbajtja e detyrueshme e kërkesëpadisë	Po Neni 191	po	Po Neni 105	Po Neni 130	Po Deklarata e kërkesëpadisë, Neni 128 (2)
Taksa gjyqësore paguhet me parashitje	Po Neni 197	po	Marrja e certifikuar e pagesës së bashkangjitur kërkesëpadisë Neni 105 a	Po me dorëzimin e kërkesëpadisë Seksioni 34(1)	Po me dorëzimin e kërkesëpadisë Seksioni 34(1)
Përgjigja ndaj kërkesëpadisë/e detyrueshme	Po Neni 205	Përshkruhet detyrimi dhe përmbajtja e përgjigjes	Po Neni 278	I detyrueshmë Nenet 275-277	Po Seksioni 148(1-4)

²⁴ <http://legislatie.just.ro/Public/DetaliuDocument/140271>

²⁵ <https://kenarova.com/law/Code%20of%20Civil%20Procedure.pdf>

²⁶ www.uis-sipo.si/fileadmin/upload/Civil_Procedure_Act_Slovenia_ZPP-2004.doc

²⁷ http://www.gesetze-im-internet.de/englisch_zpo/englisch_zpo.html#p0421

²⁸ http://www.wipo.int/wipolex/en/text.jsp?file_id=191081

²⁹ http://www.wipo.int/wipolex/en/text.jsp?file_id=332732

Mënyra e dorëzimit të thirrjeve	Gjykata Neni 154 Noteri publik, përmbaruesi Neni 162	Gjykata, përmbaruesi t	Zyrtari i gjykatës, Shërbimi postar, Agjenci private e shërbimit Neni 132	Dërgimi me postë, punonjësi i gjykatës, përmbaruesit Nenet 176-193	Posta ose dorëzimi me anë të lajmëtari (Neni 56 (1))
Menaxhimin e lëndës	Gjyqtari Nenet 216 dhe 238 (1-2)		Përgjegjësia e gjyqtarit	Përgjegjësia e gjyqtarit Nenet 136 dhe 216	
Vendimi përfundimtar <i>Res Judicata</i>		Neni 303(4)	Po Neni 339 pika 12		Seksioni 225
Shqyrtimi përgatitor	Neni 237(1 -10)	Neni 141	Shqyrtimi paraprak i kërkesëpadisë Neni 269	Jo i detyrueshëm Neni 272 dhe 276	Jo i detyrueshëm Shqyrtimi përgatitor 149 (1-9)
Shqyrtimi kryesor/urdhri për shqyrtim	Neni 216 (1 -5)	Neni 143	Po Nenet 281-288	Po Neni 136-	Po Seksioni 152(1-7)
Vazhdimet	Neni 230		Gjykata mund ta shtyjë për të mbledhur dëshmi 115	Neni 227	Po Seksioni 211(1-4)
Provat	Vetëm provat e paraqitura nga palët Neni 14	Neni 153	Provat e paraqitura nga palët Neni 8 dhe 214	Neni 355	Seksioni 91(1-4)
Shpallet vendimi i shkallës së parë	Në fund të shqyrtimit Neni 402	Në fund të shqyrtimit; Neni 235	Në fund të shqyrtimit; Në raste komplekse në shqyrtim të veçantë Neni 321	Në shqyrtimin kryesor ose në shqyrtim të veçantë jo më vonë se tre javë Neni 310	Në shqyrtimin kryesor Seksioni 187(1-2)
Përgatitet	Po	Përgatitet 30	Brenda 30	Aktgjyky	Brenda 14 ditëve

vendimi me shkrim		ditëve pas shpalljes 235(5)	ditëve pas shpalljes Neni 323	mi me shkrim duhet të përgatitet brenda tre javëve pas shpalljes Neni 315 (2)	nga shpallja Seksioni 194
Ankesa/përmbajtja e detyrueshme	Po Neni 192	Po Neni 260	Po Neni 335	Po Neni 520	Po Seksioni 416(1-3)
Mjetet e jashtëzakonshme juridike	Revizioni Neni 509; Aktgjykimi i ankesës në interes të ligjit (revizion) Neni 516	Revizioni Neni 280 Shfuqizimi i aktgjykimeve efektive Neni 303	Revizioni Neni 367; Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë Neni 37, 385-391	Revizioni (apelimi në bazë të ligjit) Neni 542 Ankesa në pikat e ligjit në lidhje me - “apel leapfrog” Neni 566 (1)	Revizionin dhe Protesta e Kasacionit nga prokurori publik Seksioni 450 (1-3)
Ndërmjetësimi	Gjyqtari e referon palën në ndërmjetësim Neni 227 (2)	Gjykata i referon palët në ndërmjetësim Neni 140(3)	Ndërmjetësimi kryhet para se të dorëzohet lënda në gjykatë	Gjykata e referon palën në ndërmjetësim Neni 278a	Palët mund të arrijnë pajtim jashtë gjykatës Neni 227 (1-4) ³⁰
procedurat e veçanta	Nuk ka procedurë të veçantë	Kontestet e vogla Neni 310; Mbrojtja e pronës së dëmtuar, Neni 356; Kontestet tregtare Neni 362; Kontestet tregtare Neni 365 dhe Kërkesëpaditë kolektive	Pengimi i pronësisë, Neni 424; Urdhërpagesa Nenet 431-441; Kontestet e vogla, Nenet 442-458; Procedura e Arbitrazhit, Nenet 459-479 Procedurat tregtare Nenet 480-497	Procedura t për kërkespaditë që rrjedhin nga kambiali; Neni 602 Procedura e shkurtër për urdhërpagesë; Neni 688	Nuk ka procedurë të veçantë

³⁰ Ndërmjetësimi nuk është futur zyrtarisht. Është vetëm projektligj për ndërmjetësimin në Letoni

		Neni 379		Procedura Evropiane për kontestet e vogla, Neni 1097	
--	--	----------	--	--	--

Kapitulli 3 Synimet dhe Objektivat

SYNIMI

Synimi i përgjithshëm i këtij koncept dokumenti është rregullimi dhe definimi i qartë i normave të procedurës civile, rritja e efikasitetit të procedurave gjyqësore kontestimore.

Një rregullim i mirëfilltë i kontribuon edhe shfrytëzimit më të mirë dhe respektimit të të drejtave pronësore.

Qëllimi është që përmes kësaj politike, të adresohen problemet e identifikuar lidhur me procedurën kontestimore, i cili në disa pjesë, ka vështirësi dhe si rrjedhojë nuk është i përshtatshëm për zbatim.

Kjo do të ndikon në arritjen e synimeve të përafrimit me politikat dhe legjislacionin e BE-së, fuqizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe fuqizimit të ekonomisë së tregut.

Përmirësimi i efikasitetit të gjykatave në zgjidhjen e lëndëve civile

Shkurtimi i kohëzgjatjes për zgjidhjen e lëndëve pronësore nga tre në një vit në periudhën prej tre vjetësh (fillon mbledhja e të dhënave pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri, Zvogëlimi i shkallës së apelimit nga 35-25% në periudhën trevjeçare (fillon mbledhja e të dhënave pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri)

Kapitulli 4 Opsionet Opsioni 1: "Status quo"

Opsioni i parë është që çështjet që trajtohen në këtë Koncept Dokument të mbeten kështu siç janë aktualisht e rregulluar d.m.th. mos ndryshimi i kësaj politike, dhe legjislacionit aktual nënkupton procedura të tej zgjatura dhe grumbullim të lëndëve nëpër gjykata. Pothuajse dhjetë vjet nga zbatimi i Ligjit për Procedurën Kontestimore (2008) ka treguar kaq shumë probleme. Koha aktuale e zgjidhjes nga gjykatat e shkallës së parë e lëndëve civile është dy herë më e gjatë sesa standardet e BE-së. Kohëzgjatja e procedurës në gjykatën e apelit është edhe më e gjatë. Nëse Kosova së shpejti bëhet anëtare e Këshillit të Evropës, një numër i madh i kërkesave do të paraqiten në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për gjykim në kohë të arsyeshme.

Opsioni 2:

Opsioni i dytë është ndryshimi i politikës aktuale përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për procedurën Kontestimore. Ligji i ri për Procedurën Kontestimore do të jetë bazë për përpunimin efektiv të lëndëve në kohë të arsyeshme. Barra e provës do të transferohet nga gjykata tek palët. Gjyqtari nuk do të ketë rol hetues ose nuk do të merr pjesë në mbledhjen e provave. Gjyqtari do të jetë arbitër i lëndës dhe do të merr vendime bazuar në provat që palët i paraqesin dhe i konfirmojnë në seancë. Gjyqtari do të jetë përgjegjës për kalendarin e gjykatës dhe do t'i lëvizë lëndët më shpejt. Në këtë sistem, palët nuk mund ta humbasin kohën e gjyqtarit, t'i vonojnë procedurat dhe ta pengojnë drejtësinë. Gjykata do t'i parandalojë këto përpjekje duke mos lejuar shtyrjet e pa arsyeshme të procedurës, duke e gjobitur palën që përpiket të abuzojë me procedurën gjyqësore, ose duke e hedhur poshtë lëndën nëse paditësi/i padituri nuk merr masa siç urdhërohet nga gjykata. Gjykata ka detyrimin që ta informojë të paditurin lidhur me kërkesën, t'i kërkojë atij të përgjigjet në padi dhe të paraqitet në shqyrtimin përgatitor. Nëse palët janë të njoftuara në mënyrë të duhur vetëm një herë, është obligim i tyre për të marrë informata nga gjykata dhe për të marrë pjesë në seanca dëgjimore.

Kapitujt/dispozitat e mëposhtme në ligje duhet të jenë subjekt i rishikimit:

1. Ligji për procedurën kontestimore:

Kreu I - DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1. Përcaktoni të gjitha të drejtat civile dhe procedurat e veçanta që rregullohen me këtë ligj

Neni 7. Barra e provës duhet t'i kalohet palëve, gjyqtari nuk duhet të hetojë dhe të mbledhë prova sipas detyrës zyrtare, ai merr vendim vetëm në bazë të fakteve që janë vërtetuar në gjykim. Sistemi kundërshtar ekziston në pothuajse të gjitha vendet e BE-së.

Gjyqtari merr vendim bazuar në faktet që janë vërtetuar në seancë dëgjimore.

Sistemi i ri është shumë efektiv dhe efikas. Palët nuk përdorin/abuzojnë me burimet e gjykatës (shtetërore) dhe me kohën për t'i vërtetuar provat e paraqitura. Kur të gjitha provat i paraqiten gjyqtarit në shqyrtimin përgatitor të detyrueshëm dhe të vërtetohen në shqyrtimin kryesor, lënda mund të mbyllet në dy seanca pasi që është standard në shumicën e vendeve të BE-së (Holanda, Suedia, Letonia, Estonia etj.).

Kreu III - PËRJASHTIMI I GJYQTARIT

Neni 67 përcakton një afat kohor në ligj në bazë të së cilit kryetari i gjykatës mund të vendosë sipas kërkesës për përjashtim (të njëjtën ditë ose brenda 72 orëve). Në shumicën e vendeve të BE-së, ky vendim merret brenda tri ditëve.

Neni 70. Rekomandohet që të caktohet afati kohor për kryetarin e gjykatës që të vendosë për përjashtimin e gjyqtarit - propozimi: ta nxjerrë vendimin të njëjtën ditë ose brenda më së shumti tri ditëve (praktika aktuale është shtatë ditë)

Kreu IV - PALËT DHE PËRFAQËSUESIT E TYRE

Nenet 73 – 84

Përmirësimi i përfaqësimit më të mirë ligjor në gjykatat më të larta (Apeli dhe Gjykata Supreme). Është praktikë e zakonshme në vendet e BE-së që avokatët me

dhjetë e më shumë vite përvojë pune i përfaqësojnë palët në gjykatat më të larta. Duhet të futet sistemi i licencimit të avokatëve për t'i përfaqësuar lëndët përpara gjykatave më të larta.

Kreu VIII - DËRGIMI I SHKRESAVE

Këto dispozita duhet të zgjerohen me futjen e subjekteve dhe mënyrave të reja të dërgimit. Dorëzimi i thirrjeve përmes përmbareshve privat (Holanda, Maqedonia dhe Rumania) dhe personave juridikë që janë të licencuar për të kryer aktivitete të tilla është gati 100 për qind i suksesshëm. Përdorimi i teknologjive të reja i ka ndihmuar gjykatave në shumë vende që të komunikojnë në mënyrë efektive me palët që janë persona juridikë dhe palët që kanë përfaqësim ligjor. Nga të gjithë personat juridikë duhet të kërkohet gjatë regjistrimit në Zyrën Qendrore të Regjistrimit që ta lënë një adresë e vlefshme elektronike për komunikim me subjektet dhe institucionet shtetërore. Në këtë mënyrë do të kursehen burime të konsiderueshme gjyqësore dhe efekti do të jetë shumë më i mirë. Meqenëse koncepti i përgjithshëm i ligjit është ndryshuar dhe barra e provës i është transferuar palëve, gjykata duhet ta ketë përgjegjësinë që t'i thërrasë palët vetëm një herë. Palët dhe/ose përfaqësuesit e tyre janë përgjegjës për t'u informuar vet lidhur me orarin e gjykatës dhe për të gjitha veprimet gjyqësore pasuese.

Kreu IX - SEANCAT DHE AFATET

Dispozitat e neneve 123-133 duhet të ndryshohen. Në shumicën e akteve procedurale të vendeve të BE-së përcaktohen afatet kohore ligjore dhe gjyqësore. Gjyqtari obligohet që t'i përfundojë procedurat dhe ta gjykojë lëndën brenda këtyre afateve. Çdo herë kur gjyqtari e humbet afatin, ai duhet ta paraqesë një elaborat me shkrim pranë kryetarit të gjykatës. Kur gjyqtarët i referojnë palët në ndërmjetësim, koha maksimale për ta mbajtur procedurën është 45 ditë. Gjyqtari mund ta pranojë vetëm një herë kërkesën e palëve për ta mbajtur procedurën gjatë kohës kur ata po përpiqen që ta zgjidhin lëndën përmes ndërmjetësimit.

Kreu X - PROCESVERBALET

Neni 140 duhet të rishikohet në lidhje me procesverbalin e marrë në procedurën e lëndëve familjare. Sistemi i trupit gjykues duhet të braktiset edhe në çështjet

familjare.

Procedurat me gjyqtarët porotë duhet të braktiset në lëndët familjare³¹.

Pjesëmarrja e gjyqtarëve porotë në trupin gjykues duhet të rregullohet me nenin 140 të ligjit³².

Kreu XI - VENDIMET GJYQËSORE

Nenet 153-169 duhet të rishikohen. Vendimi i gjykatës zakonisht shpallet në fund të shqyrtimit kryesor dhe shpallet në një seancë të veçantë brenda tetë ditëve vetëm në

³¹ Kërkohet ndryshimi i nenit 107.1 të Kushtetutës. "Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre si gjyqtarë.

³² 140.1 Në qoftë se vendimi merret në trup gjykues, për këshillimin dhe votimin përpilohet procesverbal i veçantë. Nëse gjykata e lartë e cila vendosë për ankesë vendosë unanimisht, nuk përpilohet procesverbal, por në vendim vihet shënim për këshillimin dhe votimin.

140.2 Procesverbalin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e trupit gjykues dhe procesmbajtësi.

140.3 Procesverbalin mbi këshillimin dhe votimin mbyllet në një zarf të veçantë.

raste komplekse. Në raste të tilla, data e asaj seance caktohet dhe vihet në procesverbalin e shqyrtimit kryesor. Palët duhet të paraqiten pa njoftim të veçantë. Vendimi me shkrim përgatitet brenda pesëmbëdhjetë ditëve, kurse për raste komplekse brenda një muaji. Këto afate kohore e pengojnë gjyqtarin që ta shtyjë shqyrtimin e vendimeve dhe të bëjë gabime nëse vendimi përgatitet disa javë/muaj pas seancës dëgjimore.

Rishikimi i dispozitave *Res Judicata* në nenin 166 (2) në përputhje me hartimin e projektligjeve për *Lis pendens* dhe *res judicata*, nën patronazhin e projektit ELI-UNIDROIT "Nga parimet e përkohshme për procedurën civile Evropiane"³³.

Kreu XIII - ANKESA

Dispozitat e ankesës dhe arsyet për ankesë duhet të rishikohen. Paraqitja e ndonjë fakti të ri në nivelin e apelit duhet të jetë përjashtim e jo mundësi për palët ose avokatët që të abuzojnë me procedurën dhe "të blejnë kohë".

Rekomandohet që të futet një shqyrtim i hershëm i ankesës pas pranimit në gjykatë. Ekziston një praktikë e mirë në gjykatat suedeze të shqyrtimit të hershëm të ankesës nga një trup gjykues i përbërë nga tre deri në katër gjyqtarë. Ky proces njihet si dhënia e aprovimit ose pranimit të ankesës dhe mund të jetë i dobishëm nëse futet në ligj. Kështu që shumë nga ankesat që nuk kanë bazë ligjore do të refuzohen herët.

Inkurajohet mbajtja e seancës dëgjimore në nivel të ankesës, kështu që gjykata nuk i ridërgon lëndët në gjykata disa herë³⁴. Gjykata e apelit duhet t'ia ridërgojë lëndën gjykatës vetëm një herë dhe duhet të vendosë në bazë të meritave nëse apelohe vendimi i dytë. Kjo është një praktikë e zakonshme në shumicën e vendeve të BE dhe gjithashtu ka treguar rezultate të mira në Maqedoni pasi që reforma e Ligjit për Procedurën Civile është zbatuar në vitin 2005. Kohëzgjatja aktuale e procedurës në nivel apeli është më pak se 6 muaj, që është saktësisht sa afati i përcaktuar në ligj.

Kreu XIV - MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES

Neni 211 - Rekomandohet të rritet pragu për dorëzimin e revizionit nga 3,000 në 10,000 euro për vlerën e vendimit të përmbytur.

Nenet 245 - 250 Dispozitat në lidhje me mjetin e jashtëzakonshëm juridik duhet të fshihen, Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, meqë ngrehë dyshime për shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

Kreu XXIII - PËRGATITJA E SHQYRTIMIT KRYESOR

Neni 386-389 duhet të ndryshohet. Mjetet e Menaxhimit të Lëndëve duhet të zbatohen në këtë fazë të procedurës³⁵. Përgatitja e shqyrtimit kryesor duhet të fillojë me një shqyrtim të hershëm të kërkesës - këto dispozita duhet të harmonizohen në mënyrë që gjyqtarët të lirohen nga çdo detyrë administrative në lidhje me këto çështje (asistentët ligjorë të gjyqtarëve duhet t'i kryejnë këto detyra). Shembull i mirë janë dispozitat për përgatitjen e seancës kryesore të përcaktuar në Aktin e Procedurës

³³ http://www.europeanlawinstitute.eu/fileadmin/user_upload/p_eli/News_page/UNIDROIT_Agenda_Rome_April_2017.pdf

³⁴ Grgic 2007, faqe 158, Problemi i ridërgimeve të njëpasnjëshme është identifikuar edhe në vendet tjera të pas-Jugosllavisë, në vendet e Evropës Qendrore si Polonia, Hungaria, Rumania dhe Bullgaria, si dhe në vendet pasardhëse të ish Bashkimit Sovjetik

³⁵ Parlamenti i BE-së -2014-2019 Draft raport me rekomandime për Komisionin për standardet e përbashkëta minimale të procedurës civile në BE (2015/2084 (INL) - parimet e përgjithshme të drejtimit të procedurës neni 9 (2) faqe 20

Civile të Sllovenisë³⁶. Në këtë fazë, ka detyra të shumta administrative që realizohen nga nëpunësit ligjor në emër të gjyqtarit. Gjyqtarët në Suedi dhe në Estoni pranojnë ndihmë të ngjashme.

KREU XXV - SHPENZIMET PROCEDURALE

Rishikimi i nenit 450 të LPK, i paraparë në Strategjinë Nacionale/Planin e Veprimit për të Drejtat Pronësore.

Kreu XXVIII - PROCEDURA E KONTESTEVE ME VLERË TË VOGËL

Neni 485 duhet të rishikohet në përputhje me rishikimin e fundit të Procedurës Evropiane për Konteste të Vogla (ESCP) që e ka rritur pragun nga 2000 në 5000 €³⁷ më 16 prill 2015.

Kreu XXXI - FUTJA E PROCEDURËS PËR TË DREJTAT PRONËSORE

Është me rëndësi parësore që ta kemi një procedurë të veçantë për zgjidhjen e lëndëve pronësore. Aktualisht është një numër të konsiderueshëm të lëndëve pronësore që janë ende në fazën fillestare, pra duke e pritur shqyrtimin fillestar. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre të drejtave për qytetarët, është prioritet për legjislaturën që t'i harmonizojë ligjet materiale që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore dhe ta krijojë një procedurë të veçantë për zgjidhjen e lëndëve të kontestuara të të drejtave pronësore. Kjo procedurë e re e specializuar duhet të trajtohet nga gjyqtarët më me përvojë, të cilët kanë pasur trajnime të posaçme për ligjet materiale që i rregullojnë të drejtat pronësore. Specializimi i gjyqtarëve që do t'i gjykojnë vetëm rastet e të drejtave pronësore do ta zgjidhë problemin afatgjatë të lëndëve të vjetra ekzistuese.

Sipas një sondazhi të kryer nga Projekti i USAID-it për të Drejtat Pronësore në shtator të vitit 2015, koha mesatare nga depozitimi gjer në zgjidhje të një lënde pronësore është rreth 3.5 vjet (1289 ditë) dhe mesatarja është 3.31 vjet (1142 ditë).

Duhet të mendohet që procedura Suedeze e zgjidhjes së lëndëve pronësore të sillet në Kosovë. Sipas kësaj procedure, puna e gjyqtarit mbështetet nga një punonjës igjykatës që ka specializim në njërin nga fushat e mëposhtme: gjeodezi, planifikim urban ose arkitekturë. Eksperti i gjykatës në fushat e lartpërmendura e ndihmon gjyqtarin ose në emër të gjyqtarit realizon këqyrjet në vend dhe e përgatitë raportin me shkrim.

³⁶ Në çdo kohë gjatë përgatitjeve deri në hapjen e seancës kryesore, kryetari i kolegjit ka të drejtë të vendosë:

1. për hyrjen e një paraardhësi në proces gjyqësor; 2. për ndërhyrje; 3. për sigurimin e provave; 4. për ndryshimin e veprimit; 5. për ndërprerjen e procedurave për shkak të tërheqjes së veprimit; 6. për pezullimin dhe ndalimin e procedurës; 7. për urdhrat e përkohshëm; 8. për lidhjen dhe ndarjen e kërkesëpadive; 9. për përcaktimin dhe zgjatjen e afateve të përcaktuara nga gjykata; 10. për caktimin dhe shtyrjen e seancave dëgjimore; 11. për rivendosje për shkak të vonësive; 12. për përjashtimin e një pale nga pagesa e shpenzimeve të procedurës; 13. për sigurinë për shpenzimet e procedurës.

Përgjegjës për zbatimin e këtij ligji do të jetë MD si bartëse e hatimit të këtij Ligji; ndërsa gjykatat si zbatuese direkte të këtij Ligji.

Nuk do të ketë nevojë për personel shtesë, pasi që stafi aktual në kuadër të gjykatave do të kryej detyrat që dalin nga kjo politikë, ndërsa do të ketë nevojë për trajnime për zbatimin e kësaj politike, kjo politikë mund të rezultojë me realizimin e të hyrave.

Opsioni 3:

Ky opsion parasheh angazhimin për ta përmirësuar zbatimin e ligjit aktual duke futur teknika të menaxhimit të lëndëve si:

- Shqyrtimi i deklaratave të kërkesëpadisë dhe përgjigjet e tyre me ndihmën e një liste të kontrollit. Kjo do t'u bëjë të qartë palëve se çka gjykata pret nga ata (në pista të ndryshme);
- Krijimi i një politike uniforme të vazhdimeve (drejtime praktike);
- Përgatitja e një liste kontrolli për të ndihmuar në unifikimin e mënyrës së përgatitjes dhe mbajtjes së shqyrtimit përgatitor dhe shqyrtimit kryesor;
- Hartimi i një politike të përgjithshme në lidhje me sanksionet që gjykatat mund t'i vendosin;
- Ndërtimi i ekipeve të gjyqtarëve për të punuar së bashku dhe për të qenë përgjegjës për të vendosur llojet e caktuara të lëndëve. Gjyqtarët e rinj do të përfitojnë nga puna ekipore, sepse mësojnë nga kolegët me përvojë në ekip;
- Inkurajimi i gjyqtarëve për të provuar disa herë për t'i zgjidhur lëndët. Pajtimi meriton më shumë vëmendje. E njëjta vlen (por ndoshta jo në këtë moment) për shfrytëzimin e ndërmjetësimit për t'i zgjidhur kontestet;
- Vendosja e udhëzimeve kur faktet apo dëshmitë janë të reja dhe nuk janë të pranueshme;
- Përpjekja për unifikim/harmonizim të vendosjes së sanksioneve (cilat, kur dhe kujt); dhe
- Përpjekja për të gjetur se çfarë tjetër mund të bëhet në fazën e shqyrtimit paraprak. Ky nuk mund të jetë shqetësimi për momentin, por duhet të fillohet të mendohet për këtë sa më shpejt që të jetë e mundur.

5 Përmbledhje e opsioneve

Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Status Quo	Ligji i ri me një sistem kundërshtar. Prezantimi i procedurës së posaçme për të drejtat pronësore.	Opsioni i përkohshëm deri në përfundimin e Opsionit 2
Popullsia e synuar/ sektorët/ rajonet e prekura	Të gjithë qytetarët e Kosovës	Të gjithë qytetarët e Kosovës	Të gjithë qytetarët e Kosovës
Karakteristikat e zbatimit - kush është qeveria përgjegjëse (kush), sektori privat, qytetarët	Sistemi i gjykatave	Sistemi i gjykatave Oda e avokatëve Qytetarët	Këshilli Gjyqësor i Kosovës Sistemi i gjykatave
Administrimi i programit ose i shërbimit ose lëvrimi			
Ligji, ligji dytësor, ndryshimet/ plotësimet, zbatimi, sanksionet		Ligji i ri për procedurën kontestimore	Prezantoni ³⁸ dhe zbatoheni plotësisht sistemin e menaxhimit të rrjedhës së lëndëve në të gjitha gjykatat
Nxitjet ose pengesat ekonomike - taksat ose subvencionet		Ulja e kostos së procedurave për shkak të procedurës së re efikase; të gjitha shpenzimet mbulohen nga	

³⁸Projekti i USAID/Projekti për të Drejtat Pronësore të Kosovës e ka prezantuar menaxhimin e lëndëve në tri gjykatat e meritave në Ferizaj, Gjilan dhe Pejë

		pala që e humbet rastin	
Fushatat e edukimit dhe komunikimit		Fushata edukative për t'i informuar qytetarët dhe komunitetin ligjor për rrishtë në ligj	
Udhëzimet dhe kodet			
Koha - kur do të hyjë në fuqi opsioni		2019-2020	Në mes të 2018

6 Analiza e opsioneve

Opsioni 1

A.) Përfitimet

Nuk ka përfitim nga ky opsion.

B.) Ndikim negativ

Nëse vazhdon sistemi i njëjtë i procedimit të lëndëve civile, numri i lëndëve të vjetra do të rritet vazhdimisht dhe drejtësia do të mohohet me procedurë të gjatë. Mangësitë aktuale në ligj po krijojnë procedura joefikase dhe një kërkesë artificiale për numër më të madh të gjyqtarëve. Politika e krijimit të pozitave të reja të gjyqtarëve, pa vlerësim të plotë të legjislacionit dhe zbatimit të tij, ka ndikim afatgjatë negativ. Ngarkohet buxheti i shtetit, kërkon zgjerimin e objekteve të gjykatave dhe e rritë kërkesën për stafin mbështetës administrativ.

Kjo politikë i mposhtë përpjekjet dhe synimet e përgjithshme të gjyqtarëve për zvogëlimin e numrit të lëndëve të vjetra dhe nxitjen për ta përmirësuar kohën dhe menaxhimin në zgjidhjen e lëndëve.

Opsioni 2

A.) Përfitimet

. Përfitimet kryesore nga kjo masë përfshijnë: harmonizimin e procedurës me *acquis* të BE-së dhe krijimin e një sistemi efektiv dhe efikas të gjyqimit të lëndëve civile; përmirësimi i statusit të gjyqtarit si arbitër; ulja e kostos së procedurave; dekurajimin dhe disiplinimi i palëve për të mos filluar raste të paarsyeshme dhe për ta humbur kohën dhe burimet e gjykatave etj.

Qytetarët e Kosovës do të jenë përfituesit kryesorë të kësaj zgjidhjeje. Legjislacioni i ri civil do ta mundësojë sigurinë gjyqësore, gjykimin në kohë të arsyeshme, mbrojtjen e pronës së qytetarëve dhe të drejtat tjera sendore.

B.) Ndikim negativ

I vetmi ndikim negativ që Qeveria duhet ta merr parasysh është koha dhe burimet që kërkojnë për ta realizuar reformën e tillë komplekse. Fushëveprimi i kësaj përpjekjeje legislative do të kërkojë angazhim të Ministrisë së Drejtësisë për të udhëhequr/koordinuar punën e komisionit të hartimit. Koha dhe angazhimi i njëjtë do të nevojiten edhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për t'i koordinuar aktivitetet ndërqeveritare për ta mundësuar zbatimin e rrjedhshëm të ligjit. Këto aktivitete përfshijnë: harmonizimin e ligjeve tjera të ndërlidhura; përgatitjen e akteve nënligjore; zhvillimin e një kurrikule të veçantë dhe organizimin e një sërë trajnimesh fillestare dhe të avancuara (TiT) me trajnerë nga BE/SHBA përmes Akademisë së Drejtësisë.

Opsioni 3

A.) Përfitimet

Qëllimi i opsionit 3 është që t'i minimizojë efektet negative të opsionit të status quos. Përfitimi kryesor i këtij opsioni është që gjyqtarët dhe asistentët e tyre ligjorë do ta zotërojnë çdo ditë menaxhimin e rrjedhës së lëndës (MRRL), përderisa të hartohet Ligji i ri për procedurën kontestimore.

B.) Ndikim negativ

Procesi i futjes dhe zbatimit të MRRL-së kërkon kohë. Ndikimi në kohën e zgjidhjes nuk do të shihet menjëherë gjyqtarët të mos dekurajohen dhe të fillojnë ta vënë në dyshim sistemin. Sistemi do të tregojë rezultate të rëndësishme në dy vitet e para të zbatimit të sistemit të ri kundërshtar.

7 Konsultimet

Për analizimin dhe rregullimin e çështjeve që janë objekt i trajtimit të këtij Koncept Dokumenti janë bërë konsultime me përfaqësues KGJK-së, të Gjykatave themelore, Institucioneve tjera nga lëmi i gjyqësorit, donatorët dhe shoqëria civile, konsultimet dhe si rezultat i konsultimeve ka dalë konkluzioni se është e nevojshme që të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për procedurën kontestimore

Ka pasur konsensus midis gjyqtarëve se Ligji për Procedurën Kontestimore duhet të modernizohet dhe të harmonizohet me ligjet dhe praktikat më të mira të BE-së. Ata më tej sugjeruan një rishikim të Ligjit për Gjykatat dhe më pas edhe të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) me qëllim të adresimit të problemeve me të cilat ballafaqohet aktualisht gjyqësori i Kosovës.

Konsultimet paraprake janë zhvilluar në pajtim me *nenin 7 të Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011*. Grupi punues i themeluar nga MD për hartimin e Koncept dokumentit për procedurën Kontestimore, është mbështetur nga Programi i USAID-it për të Drejtat Pronësore.

Në procesin e hartimit të këtij dokumenti janë shfrytëzuar analiza dhe hulumtime të hartuara nga USAID PRP.

Drafti i këtij koncept dokumenti është analizuar në takime ku përveç Ministrisë së Drejtësisë kanë marrë pjesë edhe Institucionet tjera që ndërlidhen me këtë fushë si: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Përfaqësuesit e Gjykatave të të gjitha niveleve, Akademia e Drejtësisë Oda e Avokateve të Kosovës, përfaqësues nga Shoqëria Civile si dhe donatorët si USAID-PRP, USAID-JSSP etj.

Ky koncept është dërguar për konsultim publik në pajtim me *nenin 32 të Rregullores së Punës së Qeverisë*.

8 Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1, status quo (asnjë ndryshim). Mangësitë aktuale në ligj po krijojnë procedura joefikase të cilat sipas vlerësimit do të vazhdojnë të mundësojnë edhe më tej një pasiguri juridike, procedura të stërzgjatura, mundësi të shtyrjeve të procedurave dhe seancave gjyqësore pa arsye shumë të bazuara të cilat si pasojë kanë si rritjen e vazhdueshme të numrit të lëndëve të vjetra dhe zgjatjen me vite të procedurave për zgjidhjen e një kontesti pronësorë. Kjo ndikon edhe në dekurajimin e njerëzve për iniciimin e procedurave gjyqësore. Ky opsion nuk rekomandohet.

Opsioni 2, ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për procedurën kontestimore, nr. 03/L-006 përmes nxjerrjes së Ligjit të ri, do të mundësonte një siguri juridike më të madhe, harmonizimin e ligjit të procedurës kontestimore me legjislacionin e BE-së për këtë fushë si dhe me praktikën e mira të shteteve tjera, krijimin e një sistemi efektiv dhe efikas të gjykimit të lëndëve civile; përmirësimi i statusit të gjyqtarit si arbitër; ulja e kostos së procedurave; pamundësimin e shtyrjes së procedurave pa arsye shumë të qëndrueshme, përcaktimi mënyrave të reja të njoftimit të palëve në procedurë dhe dërgimit të ftesave për seanca gjyqësore, përcaktimi i procedurave të veçanta për zgjidhjen e lëndëve pronësore, sistemi më i mirë i menaxhimit të lëndëve, definimi i saktë i afateve të shpalljes së aktvendimit dhe përpilimit me shkrim të vendimit, definimi i afateve për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndëve, definimi i përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike etj.

Opsioni 2 konsiderohet të jetë masa e parapëlqyer e politikës dhe rekomandohet për aprovim.

Opsioni 3. Masat e sugjeruara në opsionin 3 nuk do të kishin fuqinë e ligjit dhe kjo e krijon mundësinë e mos aplikimit në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha gjykatat. Procesi i futjes dhe zbatimit të Menaxhimit të Rrjedhës së lëndëve kërkon kohë dhe ndikimi i kësaj mase nuk do të shihet menjëherë. Gjithashtu këto masa nuk ofrojnë zgjidhjen afatgjate dhe të përgjithshme të problemit megjithatë mund të sugjeron që të aplikohen deri në aprovimin e Ligjit të ri për procedurën kontestimore si një zgjidhje e përkohshme.

9. Rekomandimi

Rekomandohet që Qeveria e Republikës së Kosovës të miratojë Koncept Dokumentin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën Kontestimore i rekomanduar në opsionin nr. 2, pasi që Ligji i ri do të krijoj bazë për përpunimin efektiv të lëndëve në kohë të arsyeshme. Do të lehtësohet dhe qartësohet mënyra e njoftimit të palëve procedurale dhe e

dërgimit të ftesave për seancë. Barra e provës do të transferohet nga gjykata tek palët. Gjyqtari nuk do të ketë rol hetues ose nuk do të merr pjesë në mbledhjen e provave. Gjyqtari do të jetë arbitër i lëndës dhe do të merr vendime bazuar në provat që palët i paraqesin dhe i konfirmojnë në seancë. Gjyqtari do të jetë përgjegjës për kalendarin e gjykatës dhe do t'i lëvizë lëndët më shpejt. Në këtë sistem, palët nuk mund ta humbasin kohën e gjyqtarit, t'i vonojnë procedurat dhe ta pengojnë drejtësinë. Gjkata do t'i parandalojë këto përpjekje duke mos lejuar shtyrjet e pa arsyeshme të procedurës, duke e gjobitur palën që përpiqet të abuzojë me procedurën gjyqësore, ose duke e hedhur poshtë lëndën nëse paditësi/i padituri nuk merr masa siç urdhërohet nga gjykata.

10 Komunikimi

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor dhe institucionet tjera përkatëse do të ofrojnë informacione lidhur me procesin e hartimit të Projektligjit, ku do të merren parasysh propozimet pas konsultimeve me ekspertë nga lëmi i gjyqësorit, me ekspert nga shoqëria civile të cilët me fushën e gjyqësorit, ekspert nga komuniteti i donatorëve etj.

Format e komunikimit do të jenë të ndryshme, duke filluar nga takimet, punëtoritë, grupet punuese, njoftimet për shtyp dhe publikimet në ueb faqen zyrtare të MD KGJK-së dhe ZKM, komunikimi do të jetë aktiv, i drejtpërdrejtë dhe konstruktiv.